



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

Numri i lëndës: 2020:051000

Datë: 16.11.2021

Numri i dokumentit: 02405369

**C.nr.1006/2020**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm**, me gjyqtarin Berat Spahiu, me bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E.Q nga Gjilani, të cilën e përfaqëson me autorizim Ilir Shaqiri avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, me objekt kontesti: Kompensim i shpenzimeve të ushqimit, në vlerë të kontestit prej 738.00 €, jashtë seancës, më datën 16.11.2021, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I.** Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkespadija e paditësit E.Q nga Gjilani dhe detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit, që paditësit t'ia paguajë shumën prej 738.00 €, në emër të shpenzimeve të ushqimit për 369 ditë pune për periudhën kohore 17.04.2017 e deri më datë 25.04.2018, me kamatë vjetore prej 8% në vit, duke filluar nga data 17.04.2020 deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm ligjor.

**II.** Detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit, që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 260 €, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi.

**A r s y e t i m**

Paditësi E.Q nga Gjilani, përmes përfaqësuesit së tij me autorizim Av. Ilir Shaqiri nga Gjilani, në këtë Gjykatë ka ushtruar padi dhe precizim të padisë ndaj të paditurës Komuna e Gjilanit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 738.00€, në emër të kompensimit të shujtave të ushqimit, për periudhën kohore nga data 17.04.2017 e deri me datën 25.04.2018, respektivisht për 369 ditë të pranisë në punë, duke e llogaritur kamatën prej 8% nga data 17.04.2021/ data e ushtrimit të padisë/ e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditë pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor. Përfaqësuesi i paditësit ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës duke i specifikuar ato.

Përfaqësuesi me autorizim i të paditurës, në përgjegjëje në padi dhe gjatës shqyrtimit kryesor e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar me ligj, duke theksuar se Gjykata Themelore në Gjilani nuk ka kompetencë lëndore për të gjykuar rastin, meqë e kompetencës lëndore është Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Qështje Administrative e

poashtu ka theksuar se Komuna e Gjilanit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, meqë nënshkruer të Kontratës së lartcekur janë MASHT-i/ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë/ dhe SBASHK-u/ Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës/ dhe se kontrata kolektive nuk prodhon efekte juridike për të paditurën, ngase e paditura nuk është nënshkruese e Kontratës. Po ashtu i njëjti e ka kundërshtuar edhe Vërtetimin e lëshuar nga SHML “ A.P ”, ”A.K ” në Gjilan edhe atë sa i përket ditëve shtesë të punës për arsye se këto ditë janë të llogaritura pas skadimit të Kontratës Kolektive që do të thotë pas datës 07.11.2020.

Gjykata analizoi secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku si në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe vërtetoi se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar me ligj, ashtu që Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të Aktgjykimit duke e detyruar të paditurën Komuna e Gjilanit që paditësit t’ia paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 738.00€, në emër të kompensimit të shujtave të ushqimit, për periudhën kohore nga data 17.04.2017 e deri me datën 25.04.2018, respektivisht për 369 ditë të pranisë në punë, duke e llogaritur kamatën prej 8% nga data 17.04.2020 / data e ushtrimit të padisë/ e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditë pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor.

Kërkesat e paditësit bazën ligjore e kanë në nenin 35, paragrafi 7 i Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë / *Kontrata nr. 24 e dt. 18.04.2017/* ngase në nenin përkatës në mënyrë shprehimore është përcaktuar se *„të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompenzimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është dy /2/ € për të punësuarit që kanë mardhënien e punës primare në institucionet arsimore.*

Në fakt në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësi ka qenë Drejtor në SHML “ A.P ”, ”A.K ” në Gjilan , ngase një fakt të tillë e konfirmon, Kontrata e Punës me nr të protokollit 05 nr.526/2015 e dt. 07.12.2015, dhe se për periudhën nga data 17.04.2017 e deri me datën 25.04.2018, ka 369 ditë të pranisë në punë, ngase këtë fakt e dëshmon vërtetimi për ditët e punës me nr të protokollit 103/2020, i datës 26.05.2020 e lëshuar nga SHML “ A.P ”, ”A.K ” në Gjilan.

Poashtu, nuk është kontestues as fakti se paditësi ju ka drejtuar të paditurës me kërkesë për kompenzimin e shujtave ditore për ushqim, ngase faktin e tillë e konfirmon vet me kërkesën drejtuar të paditurës.

Kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse mbeten faktet nëse kjo gjykatëka kompetencë lëndore për të gjykuar rastin, pasaj , nëse Kontrata Kolektive e lartcekur prodhon efekt juridike për të paditurën meqenëse nuk është nënshkruar nga ana e saj dhe nëse kemi parashkrim të kërkesave konform nenit 87 të Ligjit të Punës/ Ligji nr.03/L-212 i datës 01.Nëntor 2010/ si dhe kontestuese është edhe formulari për kërkesë dhe ankesë, të datës 17.04.2020, së bashku me kërkesën drejtuar të paditurës për kompenzim.

Lidhur me pretendimet e të paditurës gjykata arsyeton se është e kompetencës lëndore për të gjykuar rastin, pasi që sipas dispozitave ligjore të Ligjit për Gjykatat e Rregullta/ Ligjinr. 06/L – 054 në nenin 12.1 decidivisht është përcaktuar se *„Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe.* Kurse Departamenti për Qështje Administrative në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, sipas nenit 17 të Ligjit për Gjykatat gjykon qështjet administrative, respektivisht gjykon sipas padisë për hapjen e konfliktin administrativ, kur kemi një vendim administrativ të formës së prerë ndaj të cilit pala e pakënaqur ushtron padi me qëllim të realizimit të së drejtës së tij subjektive apo kur kemi të bëjmë me heshtje të administratës dhe për kategoritë e punëtorve që sipas nenit 4 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës/ Ligji Nr. 03/L-149/ mardhënia juridike e të cilëve rregullohet me këtë Ligj, të cilët sipas nenit 82 të Ligjit ndjekin procedurën e realizimit të së drejtës së tyre së pari në Komisionin për Ankesa dhe Parashpresa, pastaj i drejtohen Këshillit të Pavarur Mbikqyrës e mëpastaj me padi i drejtohen Gjykatës Themelore

në Pishinë -Departamentit për Qështje Administrative për hapjen e Konfliktit Administrativ, kurs siq dihet të punësuarve në sektorin e arsimit ju garantohet mbrojtje ligjore konform Ligjit të Punës së Kosovës.

Lidhur me pretendimet e të paditurës sa i përket vërtetimit me nr.protokoll 36 i dt.31.03.2021 se këto ditë janë llogaritur pas skadimit të afatit të kontratës kolektive që do të thotë pas datës 18.04.2020 gjykata një pretendim të tillë e refuzoi me arsyetim se neni 45 i kësaj kontratë në mënyrë të kuartë parashe se *“Nga kontrata Kolektive, palët mund të tërhiqen tre (3) muaj paara skadimit të velfshmeris së saj, përmes letrës rekomanduese, e cilat tërheqje fillon së zbatuari ditën e nënshkrimit të kontratës së re. Nëse nga Kontrata kolektive pasi t’i skadojë afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga palët zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit”.*, e në rastin konkret nuk kemi tërheqje të kontratës nga asnjëra palë,ngase kjo kontratë është vazhduar në heshtje edhe për një vit dhe gjykata konsideron se paditëses i takojnë edhe këto ditë të pune lidhur me shumatat e aprovuara.

Gjykata poashtu konstaton se e paditura qëndron në detyrimin ndaj paditësit edhe pse nuk është nënshkruse e Kontratës Kolektive të Arsimit/*Kontrata nr.24. edatës 18.04.2017/*, pasi që në nenin 2 të Kontratës është përcaktuar se kjo kontratë është e zbatueshme edhe për komunale apo DKA-të.

Detyrimi i të paditurës për pagesën e kamatës dhe kamatëvonesës prej 8% në vit është gjykuar nga Gjykata konformnenit 382 të LMD/ Ligjinr. 04/L-077 i datës 10 maj 2012, në të cilën dispozitë është përcaktuar se *„ Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. 2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.*

Ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës, Gjykata e bazoi në nenin 452.1 të LPK-së, duke marrur parasysh suksesin e paditësit në kontest, ashtu që e detyroi të padituren që t’ia kompenzoj paditësit shpenzimet në lartësi prej 260.00€, në afat prej 7 ditë pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi edhe ate për përpilimin e padisë shumen prej 104.00€, taksa gjyqësore në lartësi prej 21.00€ dhe për një përfaqësim gjyqësor të avokatit 135.00 €.

Nga të cekurat më lartë, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të Aktgjykimit.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**2020:051000, 16.11.2021**

**G j y q t a r i,**  
Berat Spahiu

**Udhëzim mbi Mjetin Juridik:** kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditësh, pas ditës së pranimit, përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2020:051000  
Datë: 16.11.2021  
Numri i dokumentit: 02405369

Numri i lëndës: 2020:051000  
Datë: 16.11.2021  
Numri i dokumentit: 02405369